



# BULETIN MUJOR

SHKURT 2025



## PËRMBAJTJA

- Dita e Internetit të Sigurt – z. Tafa: “Siguria kibernetike nuk njihet kufij, nevojitet bashkëpunim i ngushtë”
- Shqipëria kampione e Sigurisë Kibernetike në Ballkan për të dytin vit radhazi!
- Trajnim dhe Shkëmbim Eksperiencash për CSIRT-et e Ballkanit Perëndimor në Bashkëpunim me CERT-in e Polonisë
- Prezantohet Platforma SimSpace - Pjesë e Trajnimeve Të Sigurisë Kibernetike
- AKSK trajnon përfaqësuesit e infrastrukturave kritike dhe institucioneve të pavarura për përdorimin e teknologjive alternative dhe Open Source.

## Dita e Internetit të Sigurt/ z. Tafa: “Siguria kibernetike nuk njihet kufij, nevojitet bashkëpunim i ngushtë”



Në Ditën e Internetit të Sigurt, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) organizoi një takim rajonal për sigurinë kibernetike, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Takimi mbledhi përfaqësues nga 13 vende të SEECP dhe organizata ndërkombëtare për të diskutuar sfidat dhe forcimin e bashkëpunimit për një hapësirë digjitale më të sigurt. Drejtori i AKSK, Igli Tafa, theksoi rëndësinë e koordinimit dhe ndarjes së informacionit për mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike, ndërsa Antonela Dhimolea theksoi harmonizimin e politikave me BE-në dhe NATO-n. Takimi u përmbyll me angazhimin për forcimin e partneriteteve dhe përpjekjeve për të përbushur standardet globale të sigurisë kibernetike.

## Shqipëria kampione e Sigurisë Kibernetike në Ballkan për të dytin vit radhazi!

Ekipi i ekspertëve të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit kanë fituar sërish vendin e parë në Balkans Live-Fire Cybersecurity Exercise, duke tejkuluar ekipet e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. Ky ushtrim tre-ditor, i organizuar në Tiranë nga CybExer Technologies dhe e-Governance Academy (eGA), sfidoi ekspertët në mbrojtjen e një infrastrukture të plotë IT ndaj sulmeve të simuluar nga një Red Team i specializuar.

Ky sukses vërteton edhe një herë përgatitjen dhe aftësinë e ekipit tonë në zbulimin, mbrojtjen dhe reagimin ndaj kërcënimeve kibernetike në kohë reale. Shqipëria po ndërton një sistem të fortë mbrojtjeje kibernetike dhe ky rezultat është një dëshmi tjetër e përkushtimit të ekspertëve tanë!



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



[www.aks.gov.al](http://www.aks.gov.al)



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



## Trajnim dhe Shkëmbim Eksperiencash për CSIRT-et e Ballkanit Perëndimor në Bashkëpunim me CERT-in e Polonisë

Përfaqësues të ekipeve kombëtare të reagimit ndaj incidenteve kibernetike nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut morën pjesë në një trajnim me CERT-in e Polonisë, organizuar nga DCAF dhe mbështetur nga GIZ. Aktiviteti synoi forcimin e kapaciteteve teknike dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal për sfidat kibernetike.

Drejtori i AKSK, Igli Tafa, vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e reagimit ndaj incidenteve kibernetike, ndërsa Ambasadori i Gjermanisë, Karl Bergner, vlerësoi progresin e Shqipërisë dhe rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për adresimin e kërcënimeve kibernetike. Shkëmbimi i eksperiencave mbetet kyç për përmirësimin e mbrojtjes kibernetike në rajon.

## Prezantohet Platforma SimSpace - Pjesë e Trajnimeve Të Sigurisë Kibernetike

Ekspertët nga infrastruktura kritike e informacionit morën pjesë në një trajnim të organizuar nga AKSK, ku u testua platforma SimSpace për simulimin e sulmeve kibernetike.

Drejtori i AKSK, Igli Tafa, theksoi rëndësinë e trajnimeve të specializuara dhe rolin e platformave si SimSpace në forcimin e aftësive të ekspertëve. Ky aktivitet është pjesë e angazhimit të AKSK për rritjen e kapaciteteve dhe mbështetje për ekspertët në fushën e sigurisë kibernetike.



## AKSK trajnon përfaqësuesit e infrastrukturave kritike dhe institucioneve të pavarura për përdorimin e teknologjive alternative dhe Open Source.

Në Laboratorin e Sigurisë Kibernetike të AKSK u zhvillua një trajnim për përfaqësuesit e infrastrukturave kritike dhe institucioneve të pavarura, me fokus në rritjen e kapaciteteve teknike për përdorimin e teknologjive alternative dhe platformave Open Source.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të angazhohen në një simulim Live-Fire, ku testuan aftësitë e tyre për të identifikuar dhe reaguar ndaj sulmeve kibernetike duke përdorur mjete si Firewall, SIEM, EDR, WAF, IDS/IPS dhe sisteme monitorimi.

